



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Agjencinë Kombëtare të
Burimeve Natyrore”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI TEMATIK

MBI

“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË
MBI REALIZIMIN E AKTIVITETEVE BAZUAR NË OBJEKTIVAT E
VENDOSURA NGA NJËSIA”

TIRANË, QERSHOR 2024

| NR. | Përmbajtja | Faqe |
|------------|--|-------------|
| I | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 3-4 |
| II | HYRJA | - |
| 1 | Objektivat dhe qëllimi | 6-6 |
| 2 | Identifikimi i çështjes | 6-6 |
| 3 | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | 6-6 |
| 4 | Përgjegjësitë e audituesve | 6-6 |
| 5 | Kriteret e vlerësimit | 6-6 |
| 6 | Standardet e auditimit | 6-7 |
| 7 | Metodat e auditimit | 7-7 |
| 8 | Dokumentimi i auditimit | 7-7 |
| III | PËRSHKRIMI I AUDITIMIT | |
| 1 | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim | 8-9 |
| 2 | Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit | 9-26 |
| IV | REKOMANDIME | 26-31 |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Bazuar në Autorizimin e Auditimit me nr. 159 prot., datë 29.01.2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit kreu auditimin tematik “Mbi procedurat e rekrutimit”; “Dëmshtëpërblimet e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna”; si dhe “Mbi realizimin e aktiviteteve bazuar në objektivat e vendosura nga njësia”. Auditimi u ushtrua në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

KLSH e ka vlerësuar të rëndësishëm kryerjen e këtij auditimi për shkak të ankesave të njëpasnjëshme protokolluara në KLSH, në lidhje me problematikat e trajtuara nga grupi i auditimit në këtë Raport Auditimi.

a. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 9.8.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar. Në zbatim të pikës 7, të VKM Nr. 547, datë 09.08.2006 është miratuar Statut-Rregullorja e AKBN me status juridik “ent publik” në varësi të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Objekti i veprimtarisë së këtij institucioni është zhvillimi dhe mbikëqyrja e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, monitorimi i postshfrytëzimit të tyre në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energji. Funksionimi, struktura organizative dhe struktura e pagave të AKBN përcaktohen në Statut-Rregulloren e AKBN-së, të ndryshuar, ndërsa marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen sipas Kodit të Punës. Organet drejtuese të AKBN-së, bazuar në nenin 7 të Statut-Rregulloreve të saj, të ndryshuar, janë:

1. Këshilli Drejtues
2. Drejtori Ekzekutiv
3. Zv./Drejtori Ekzekutiv

Këshilli Drejtues (KD) është organ kolegjal vendim-marrës, për mbikëqyrjen e funksionimit dhe veprimtarisë së AKBN-së, i cili përbëhet nga 7 anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari, që emërohen dhe lirohen nga **Ministri**.

Në nenin 4 të statut rregulloreve se miratuar, jepet një përkufizim më i gjerë të përcaktimit të VKM-së nr.547, datë 09.08.2006, me të cilën u krijua ky ent publik. Kështu citojmë “AKBN, nuk financohet nga buxheti i shtetit. Megjithatë agjencia ka të drejtë të përfitojë projekte të financuara nga buxheti i shtetit apo subjekte të tjera.

Për shërbimet që ofron, siguron të ardhura në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj. Buxheti i agjencisë miratohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

b. Mbulimi i shpenzimeve të këtij institucioni realizohet nga të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i tyre. Sa i takon situatës financiare, nga grupi i auditimit u konstatua se institucioni i AKBN-së, gjendet në vështirësi financiare që prej vitit 2021, duke sjellë që në vitin 2022 dhe 2023, në planifikimin buxhetor të të ardhurave dhe shpenzimeve që pritet të kryejë institucioni, konstatohet dhe vërehet se janë planifikuar më shumë shpenzime, sesa të ardhura që pritet të gjenerohen.

c. Realizimi i këtij auditimi u bazua në metodologjinë e auditimit të përcaktuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 7, datë 17.01.2024, si verifikimi i procedurave të ndjekura, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre; Intervistimi, është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet; Raporte dhe informacione, janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 5 gjetje masa organizative dhe ka dhënë 7 rekomandime, 1 masë shpërblim dëmi dhe një masë 3E.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi në terren vijojnë si më poshtë:

- Për Procedurat e emërimit të punonjësve për vitin 2022 në total 13 raste dhe për vitin 2023 në total 4 raste, Drejtoria e Administratës ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë për plotësimin e kriterëve të kërkuara me dosjen e dorëzuar të aplikantit, dhe në të njëjtën kohë ka qenë monitoruese dhe pjesë e komitetit Ad Hoc të përzgjedhjes së kandidatëve.

- Kriteret e vendosura në njoftimin për Web janë ndryshuar nga kriteret e kërkuara nga Drejtoria i drejtorisë përkatëse, që bën kërkesën për plotësimin e pozicionit me specialistin e fushës, veprim i cili nuk është shoqëruar me një procesverbal të mbajtur midis palëve për ndryshimin e kriterëve veprim në kundërshtim me Statut-rregullores dhe Rregullores e AKBN-së.

- Në kriteret e kërkuara përcaktohet se aplikanti duhet të ketë kryer studimet specifike të universiteti/fakulteti (si p.sh Fakulteti i Ekonomisë ose Universiteti Politeknik i Tiranës) dhe jo përcaktimi i fushës së studimit. Kriteret e kërkuara nuk janë objektive dhe jodiskriminuese, me qëllim sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë aplikantët në tregun e punës.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Statut-rregullores dhe Rregullores e AKBN-së neni 25, pikës 2 dhe 26.

- Nga auditimi i dosjeve të personelit rezultoi se për tre punonjës është lidhur kontratë me palëve pa ndjekur procedurën e rekrutimi, si dhe në mosplotësim të kriterëve për pozicionin e përkatës, parashikuar në rregulloren e brendshme të AKBN-së, në seksionin përshkrim i punës.

- Nga auditimi mbi emërimet rezultoi se, kalimet nga një kategori në tjetrën të punonjësve (ku një pjesë e lëvizjeve janë nga specialist në shefe sektori, pa kaluar më parë specialist i parë) janë të pa bazuar në një vlerësim përformance të stafit, pasi në AKBN për vitet me radhë nuk është bërë asnjë vlerësim përformance. Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, dhe me Nenin 10 “Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë” të Rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

- Nga auditimi i dosjeve të largimit të stafit rezultoi se, për 3 punonjësit e larguar në asnjë rast nuk janë përcaktuar shkaqet e justifikuar të largimit nga puna sipas përcaktimit të nenit 153 të Kodit të Punës. Nga një interpretim logjik i dispozitës përcaktohet parimisht se dy janë kushtet kryesore për t’u plotësuar që zgjidhja e kontratës të jetë e rregullt dhe e justifikuar: *kushtet subjektive dhe kushtet objektive*.

Sa më sipër, në lidhje me largimet nga puna, të cilat janë zgjidhjet e njëanshme të kontratave të punës dhe të paargumentuara sipas Kodit të Punës, do të mund të çojë në *shkaktimin e dëmit ekonomik*, për proceset gjyqësore, të cilat mund të iniciohen nga punonjësit e larguar pa shkaqe të justifikuar.

- Në një rast është bërë shkëputja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës, duke mospranuar kërkesa për dorëheqje e paraqitur me e-mail nga punonjësit, si dhe duke u mos respektuar neni 144 i Kodit të punës pika 4.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua se:

- Drejtoria e Administratës është kryetar i komisionit të blerjeve të vogël dhe në të njëjtën kohë miraton kërkesat për nevojat, zhvillon procedurat e prokurimit, merr në dorëzim mallrat/shërbimet në rolin e komisionit të marrjes në dorëzim të tyre si dhe referuar urdhrin me nr. 31, (prot. 2149) datë 07.02.2018, Drejtoria e Administratës është pjesë e “Njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizueseve.”

Sa më sipër kemi mospërputhshmëri të funksionit të Drejtoria e Administratës, pasi nuk mund të jetë njëkohësisht dhe Drejtore Administrate dhe kryetare komisioni blerjesh dhe në të njëjtën kohë dhe sinjalizuese.

- Në tre procedura, kryetari i komisionit ka qenë me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta.

Gjithashtu, nga auditimi i listë prezencës për muajin Shkurt, Mars, Maj, Qershor, Tetor dhe Nëntor 2022 rezultoi se: Drejtoria e Administratës ka marrë shpenzime dieta brenda vendit dhe

nuk figuron në listëprezencë me Shërbim, ashtu siç deklarohet për të gjithë punonjësit, ku në datat të cilat kanë qenë më shërbim dhe janë paguar për shpenzime dieta janë shënuar në listëprezencën me shërbim, bazuar në rregulloren e brendshme të AKBN-së.

- Nga auditimi rezultoi se AKBN duke qenë në kushte të vështira financiare ka bërë deklaratimet e “Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” si dhe “Deklarimi mujor i tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (TAP)”, por nuk janë derdhur ato për muajt Nëntor –Dhjetor 2023 dhe Janar Shkurt 2024, ku vlera e përlllogaritur e sigurimeve dhe TAP të papaguar është në shumën prej 36,659,853 lekë. Mos derdhja e detyrimeve ka sjellë vlerë financiare për tu paguar për kamatëvonesat dhe gjobë për pagesë të vonuar, e cila vazhdon të akumulohet dhe të rritet për faktin se vlera e kamatëvonesës llogaritet mbi vlerat të cilat janë të papaguara, konsiderohet Efekt Financiar Negativ për fondet publike, ku deri me datën 29.03.2024 vlera e përlllogaritur e kamatëvonesave dhe gjobave për pagesë të vonuar është në shumën prej 1,632,573 lekë.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, të marrë masa në vijimësi, që në urdhrin për ngritjen e komisionit Ad Hoc, për rekrutimin e punonjësve, anëtarët e tij të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesit me pozicionin dhe përshkrimet e punës të përcaktuara në Statut-rregulloren dhe Rregulloren e AKBN-së.
- Nga Drejtoria e Administratës së AKBN-së, të merren masat në vijimësi që kriteret e përgjithshme të kërkuara për pranimin e punonjësve në punë të shpallura në faqen zyrtare WEB të bazohen në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike dhe të mos bien ndesh me kriteret e kërkuara nga Drejtoret e Drejtorive përkatëse.
- Nga AKBN, të merren masat të menjëhershme për rishikimin e rregullores së brendshme, duke parashikuar rregulla të qarta në lidhje me rekrutimin e punonjësve, emërimet e përkohshme, si dhe procedurave të ngritjes në detyrë të stafit, me qëllim mirë administrimin e proceseve të punës në realizimin e objektivave të institucionit.
- Nga Titullari i Institucionit të AKBN-së të merren masat që të analizohen këto parregullsi dhe të procedohet me marrjen e masave të nevojshme disiplinore e administrative, si dhe në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të njëanshme nga AKBN, të ndiqen të gjitha procedurat për përcaktimin e shkaqeve për ndërprerjet e marrëdhënieve të punës në rastet e kontratave me afat të caktuar apo pa afat, me qëllim shmangien e shkaktimit të dëmit nga mos ndjekja në përputhje me kriteret e përcaktuara për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.
- Nga Titullari i AKBN të merren masa, që të identifikohen në mënyrë të qartë rolet, funksionet dhe përgjegjësit administrative të zyrtarëve dhe në ngritjen e komisioneve për çështje të caktuara të funksionimit të brendshëm të AKBN-së të mbahen parasysh përcaktimet ligjore në fuqi, me qëllim shmangien e kushteve të konfliktit të interesit, si dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.
- Nga AKBN të merren masa për vlerësimin e dokumentacionit, në lidhje me shumën prej 121,000 lekë përfituar padrejtësisht nga Drejtori i Administratës, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës.
- AKBN në bashkëpunim me Ministrinë e linjës/Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masa të menjëhershme për raportimin e situatës dhe gjetjen e mundësive të zgjidhjes, me qëllim shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve dhe TAP.

Në përfundim të auditimit, u hartua Raporti i Auditimit Tematik, ku nga subjekti i audituar sipas tematikës së këtij auditimi të përcaktuar në Autorizimin e Auditimit, janë paraqitur observacionet mbi Projekt Raportin, protokolluar në KLSH me nr.159/5, datë 15.05.2024; 669, datë 14.05.2024 dhe 159/9, datë 20.05.2024.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Nga auditimi në terren, ka rezultuar se Sistemi i Kontrollit të Brendshëm i ngritur në AKBN, nuk ka funksionuar në mënyrën efektive, pasi janë konstatuar parregullsi në çështjet e lidhura me marrëdhëniet e punës si, procedurat e emërimeve, ngritjet në detyrë, emërimet e përkohshme, largimet etj., si dhe rastet e evidentimit të konfliktit të interesit në realizimin e detyrave funksionale, mangësi në zbatimin e kërkesave të legjislacionit mbi procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, vështirësi financiare e mungesë e aftësisë paguese, mos derdhje në afat e detyrimeve financiare për tu paguar duke krijuar efekte financiare, kamatëvonesa dhe penalitete për institucionin etj.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Autorizimit të Auditimit nr.159 prot., datë 29.01.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore u krye auditimi tematik “Mbi procedurat e rekrutimit”; “Dëmshtëpërblimet e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna”; si dhe “Mbi realizimin e aktiviteteve bazuar në objektivat e vendosura nga njësia” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. J. G.
2. A. Gj.
3. A. K.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Objekt i këtij auditimi është auditimi tematik i përputhshmërisë, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “Kriteret e vlerësimit”. Ky auditim ka si qëllim:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.
- Aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe korrektesisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë dhe sjelljen e zyrtarëve publik), referuar ISSAI/IFPP 4900 të INTOSAI-t.
- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.
- Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes.

Referuar tematikës së auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

- Mbi procedurat e rekrutimit;

- Dëshmepërblimet e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna;
- Mbi realizimin e aktiviteteve bazuar në objektivat e vendosura nga njësia.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të AKBN-së, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së AKBN-së, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

- Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;
- Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit.

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin dhe Kontrollim Financiar" i ndryshuar.
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.
- Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".
- VKM nr. 547, datë 09.08.2006 "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", i ndryshuar.
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar
- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit".
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" i ndryshuar.
- Statut Rregullorja e AKBN miratuar prej Ministrit me vendimin nr.545 datë 05.07.2018.
- Rregullore e brendshme miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr.7 datë 20.06.2018.
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorin publik", i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

- ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”
- ISSA 130 “Kodin Etik”
- ISSAI 2315 “Risku”
- ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”
- ISSAI 2500 “Dokumentimi”

7. Metodatat e auditimit

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale dhe teste kontrolli. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe është konsideruar me risk të mesëm, për këtë arsye për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, janë aplikuar:

- Verifikimi i transaksioneve, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- Intervistimi, është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione, janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të.

8. Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 7, datë 17.01.2024, Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat. Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është dokumentuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat e kryera prej tij.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka si objekt të veprimtarisë së saj, zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e post shfrytëzimit të tyre, në sektorin minierar, hidrokarbur dhe energjetik.

Fusha e veprimtarisë së AKBN konsiston në:

- a) Propozimin, konsultimin, dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të Qeverisë për hartimin e politikave të saj dhe strategjive në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- b) Zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- c) Sigurimin brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minierare, postminierare, hidrokarbure dhe të energjisë, të

paraqitura nga subjektet shtetërorë a privatë, vendas ose të huaj. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;

d) Promovimin e burimeve minerare, hidrokarbure, hidrike dhe burimeve të rinovueshme të energjisë;

e) Negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure dhe minerare dhe ndjekjen e zbatimit të planeve të zhvillimit të tyre;

f) Përgatitjen e dokumentacionit dhe praktikave të nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas marrëveshjeve të lidhura;

g) Ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure;

h) Mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike;

i) Realizimin e monitorimit të zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;

j) Monitorimin, e kontratave konçensionare për hidrocentralet;

k) Administrimin ekskluzivisht të të gjitha të dhënave parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare;

l) Propozimin e masave për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin energjetik;

m) Hartimin dhe publikimin e bilancit energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të tematikës së Autorizimit të Auditimit me nr. 159 prot., datë 29.01.2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, protokolluar në AKBN me nr. 866, datë 01.02.2024 Kontrolli i Lartë i Shtetit kreu auditimin tematik me objekt/fokus çështjet e mëposhtme:

“Mbi realizimin e aktiviteteve bazuar në objektivat e vendosura nga njësia”; “Mbi procedurat e rekrutimit” si dhe “Dëshmipërblimet e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna”.

1. Mbi realizimin e aktiviteteve bazuar në objektivat e vendosura nga njësia.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me nr. 547, datë 9.8.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar. Në zbatim të pikës 7, të VKM Nr. 547, datë 09.08.2006 është miratuar Statut-Rregullorja e AKBN me status juridik “ent publik” në varësi të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në nenin 20 të statut rregullores është përcaktuar se: Për të gjithë veprimtarinë e saj ekonomike-financiare, AKBN përgatit programin ekonomik (buxhetin) dhe programin e zhvillimit për çdo vit kalendarik. Për projektet e financuara nga buxheti i shtetit, AKBN operon në përputhje me udhëzimet vjetore të MIE.

Ndërkohë, neni 22 përcakton burimet e financimit të aktivitetit të AKBN, duke përfshirë, projekte dhe shërbime për të tretë, administrimi i të dhënave, bonuse dhe fondet, kualifikim-administrim, nga marrëveshjet hidrokarbure, shitja e pjesës së shtetit në një marrëveshje hidrokarbure, projektet e financuara nga buxheti i shtetit, interesat bankare, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.” Sa i takon situatës financiare, nga grupi i auditimit u konstatua se institucioni i AKBN-së, gjendet në vështirësi financiare që prej vitit 2021, duke sjellë që në vitin 2022 dhe 2023 , në planifikimin buxhetor të të ardhurave dhe shpenzimeve që pritet të kryejë institucioni, konstatohet dhe vërehet se janë planifikuar më shumë shpenzime, sesa të ardhura që pritet të gjenerohen. Kjo situatë është parashikuar që në vitin 2021, ku nga AKBN janë dërguar shkresat si vijon:

Nëpërmjet shkresave nr. 858/14 prot., date 05.11.2021, nr. 618/5 prot., datë 11.04.2022, nr. 1501/23 prot., datë 29.04.2022, Nr. 618/10 prot., datë 09.06.2022, nr. 618/14 prot., datë

29.07.2022, nr.618/19 prot., datë 14.09.2022, nr. 618/26 prot., datë 08.11.2022, AKBN i është drejtuar MIE, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit lidhur me situatën e vështirë financiare të institucionit për kryerjen e pagesave të avokateve dhe ekspertëve si dhe sugjerimin e shlyerjes së pagesave të të gjitha shpenzimeve gjyqësore që lidhen me këtë proces nga Albpetrol sha.

AKBN në datën 02.03.2022, ka kryer pagesën e faturës së parë studios ligjore H... L.... në vlerën 250,000 Euro.

Duke patur parasysh gjendjen e vështirë financiare në të cilën ndodhet institucioni, AKBN iu drejtua MIE (shkresa 618/14 datë 29.07.2022), lidhur me gjetjen e mundësive për kryerjen e pagesave nga Albpetrol sha. Me shkresën nr. 1101/12, datë 29.07.2022, MIE i është drejtuar shoqërisë Albpetrol sh.a për realizimin e kërkesës së AKBN-së lidhur me pagesat e shpenzimeve paraprake gjyqësore. Kjo pagesë u realizua nga Albpetrol sha në datën 02.08.2022 për shpenzimeve gjyqësore ICC në vlerën 150 000 USD në favor të AKBN.

Gjithashtu bazuar në Aktin Normativ Nr. 12 datë 01.12.2022, si dhe shkresës së MIE drejtuar Albpetrol sha me nr. 23 15/3 prot. datë 12.12.2022, MIE ka kryer pagesën për studion ligjore H... L.... në vlerën 550,000 Euro, ndërsa Albpetrol sh a ka kryer pagesën ndaj dy ekspertëve në vlerën 361,250 USD.

Në kushtet e nevojës urgjente për kryerjen e pagesës të ambienteve me qira për seancat dëgjimore sipas shkresës së Avokaturës së Shtetit nr. 44/3 datë 26.01.2023, me qëllim mbarëvajtjen e procesit të arbitrazhi, AKBN ka kryer pagesën e pjesës takuese në vlerën 20,555 Euro në datën 27.01.2023.

Sa më sipër, me shkresën nr.3320 prot., datë 14.07.2023 dhe nr.3320/2 prot. datë 27.09.2023, Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së ka informuar Këshillin Drejtues në AKBN dhe Ministrin e MIE-s në lidhje me problematikat në lidhje me situatën ekonomiko-financiare, ku nga kryerja e analizës së të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme më të domosdoshme, me qëllim mirëfunksionimin e institucionit, nevojiten fonde shtesë në vlerën prej 210 milionë lekë. Gjithashtu, institucioni i AKBN-së ka përcjellë në MIE relacionin me propozime për disa ndryshime në ligjin “Për taksat kombëtare”, nëpërmjet të cilit është propozuar kalimi i një pjese të të ardhurave nga renta minerare në buxhetin e institucionit.

Konkluzion:

Nga auditimi rezultoi se AKBN duke qenë në kushte të vështira financiare nuk ka paguar punonjësit për muajt nëntor, dhjetor të vitit 2023 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2024 në kohë.

Pagesa e pagave për muajin nëntor, dhjetor të vitit 2023 dhe Janar të vitit 2024 janë paguar në Mars të vitit 2024 pas një huaje të marrë nga Alpetrol.

Nga AKBN janë bërë deklaratimet e “Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” si dhe deklaratimet mbi të “Deklarimi mujor i tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (TAP)”, **por nuk janë paguar ato për muajt Nëntor –Dhjetor 2023 dhe Janar Shkurt 2024, ku vlera e përlogaritur e sigurimeve dhe TAP së papaguar është në shumën prej 36,659,853 lekë.**

Veprime në kundërshtim me nenin 11, të Ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” përcakton se “Jo më vonë se data 20 e muajit që pason periudhën tatimore për tatimpagues të regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim mbi fitimin; për tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim i thjeshtuar mbi fitimin kryhet brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik” . Ku sipas përcaktimit të Neni 19 “Kamatëvonesat për pagesën e vonuar”, pika 1 “Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, mbahen kamatëvonesat për pagesë të vonuar, ku masa e kamatëvonesës për pagesë të vonuar është ajo e përcaktuar në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” neni 10 “Mbledhja e tatimit” ku përcakton se “Çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërbllim të parashikuar në gërmën “a”, të nenit 8 të

këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës”.

Referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 76 "Kamatëvonesa" ku përcaktohet se "Kur detyrimi tatimor nuk paguhet në afat, tatimpaguesi është i detyruar që, për periudhën nga afati i pagesës deri në datën e pagesës së tatimit, të paguajë kamatëvonesë për këtë shumë, në masën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni" si dhe nenit 114 "Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributi" ku përcakton se "Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer”.

Sa më sipër AKBN i është shtuar një vlerë financiare që konsiderohet Efekt Financiar negativ për fondet publike për t'u paguar për kamatëvonesat dhe gjobë për pagesë të vonuar, e cila, e përlllogaritur vetëm për periudhën Nëntor 2023-Shkurt 2024 rezulton në shumën 38,291 mijë leke, cila vazhdon të akumulohet dhe të rritet për faktin se vlera e kamatëvonesës llogaritet mbi vlerat të cilat janë të papaguara.

Deri me datën 29.03.2024 vlera e përlllogaritur e kamatëvonesave dhe gjobave për pagesë të vonuar është:

Lekë

| | Nentor | Dhjetor | Janar | Shkurt |
|---------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Principal | 9,109,968 | 9,119,990 | 9,246,144 | 9,183,751 |
| Gjobe | 546,597 | 366,623 | 210,811 | 49,592 |
| Interes | 213,294 | 143,636 | 82,592 | 19,428 |
| Totali | 9,869,859 | 9,630,249 | 9,539,547 | 9,252,771 |

2. Marrëdhëniet e punës:

Në statut rregulloren e AKBN në nenin 24 "Marrëdhëniet e punës" është përcaktuar se marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i punës me ndryshimet përkatëse.

Procedura e punësimit emërimit dhe lirimit të punonjësve të AKBN-së do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

2.1. Nga auditimi i procedurave të emërimit të punonjësve rezultoi se janë emëruar në total 13 punonjës për vitin 2022 dhe 4 punonjës për vitin 2023.

Në dosjet e rekrutimit janë bashkëlidhur dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa e drejtorit për plotësimin e vendit vakant në drejtoritë përkatëse drejtuar Drejtorisë së Administratës dhe Drejtorit ekzekutiv duke përcaktuar kërkesën e pozicionit vakant me specifikimet dhe kriteret e këtij pozicioni;
2. Njoftimi në faqen WEB e miratuar nga Drejtoria e Administratës, ku në pjesën me të madhe të dosjeve është i njëjti numër protokollit me kërkesën;
3. Urdhri për krijimin e komitetit Ad Hoc miratuar nga Drejtori Ekzekutiv, ku në përbërje të komisionit është Drejtoria e drejtorisë që ka bërë kërkesën për plotësimin e vendit vakant, Drejtoria e Drejtorisë së Administratës dhe Shefi Sektorit të Burimeve Njerëzore;
4. Procesverbali i mbajtur nga komisioni në të cilën është bërë dhe shpallja e kandidatit fitues relatohet fituesi pa një sistem pikëzimi;
5. Urdhri i Drejtorit Ekzekutiv për emërimin në punë të kandidatit të shpallur fitues nga komisioni Ad Hoc.

Konkluzion:

Nga auditimi rezultoi se:

- Drejtoria e Administratës nuk ka një plan vjetor të nevojave për personel të drejtuar dhe miratuar nga Drejtori Ekzekutiv bashkë me propozimet e ardhura nga Drejtoritë e AKBN-së, veprime në kundërshtim me nenin 25 “*Strukturat për pranimin në punë*” të Statut-rregullores dhe Rregullores e AKBN-së.

Procedurat e emërimit të punonjësve për vitin 2022 në total 13 raste dhe për vitin 2023 në total 4 raste janë kryer në kundërshtim me Statut Rregulloren dhe Rregulloren së AKBN-së pasi referuar pikës 2, të nenit 26 përcaktohet se:

-*Drejtoria e Administratës pranon aplikimet dhe monitoron fazën e përzgjedhjes*, pra nuk mund të jetë në të njëjtën kohe monitorues dhe pjesë e komitetit ad hoc të përzgjedhjes së kandidatëve.

-*Shefi i sektorit të burimeve njerëzore bën përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë për plotësimin e kriterëve të kërkuara me dosjen e dorëzuar të aplikantit*, pra nuk mund të jetë pjesë e komitetit ad hoc të përzgjedhjes së kandidatëve.

Në të gjithë procedurat rekrutimit është mbajtur vetëm një Procesverbal nga komiteti Ad Hoc, në të cilën është relatuar shpallja e kandidatit bazuar vetëm në dosjen e dorëzuar nga aplikantët, pa një sistem pikëzimi siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 26 “*Komiteti ad hoc përcakton subjektet e testimit me shkrim dhe mënyrën e vlerësimit*”.

Sa më sipër e gjithë procedura e rekrutimit është kryer në kundërshtim me nenin 24, të Statut Rregullores dhe nenin 26 të rregullores së AKBN-së.

Konkluzion:

Nga auditimi i kriterëve të vendosura në njoftimin për web rezultoi se:

- Nga Drejtori i Drejtorisë së Administratës, i cili përgatit dhe firmos urdhrin e njoftimit për WEB janë ndryshuar kriteret e vendosura nga Drejtori i drejtorisë përkatëse, që bën kërkesën për plotësimin e pozicionit me specialistin e fushës, veprim i cili nuk është shoqëruar me një procesverbal të mbajtur midis palëve për ndryshimin e kriterëve.

- Në kriteret e kërkuara përcaktohet se aplikanti duhet të ketë kryer studimet specifike të universiteti/fakulteti (si p.sh Fakulteti i Ekonomisë ose Universiteti Politeknik i Tiranës) dhe jo përcaktimi i fushës së studimit. Kriteret e kërkuara nuk janë objektive dhe jodiskriminuese, me qëllim sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë aplikantët në tregun e punës.

2.2. Rikthimet në punë të punonjësve pas ristrukturimit të 2017.

Në vitin 2017 nga AKBN është bërë ristrukturim ku janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 39 punonjës, për të cilët AKBN ka paguar detyrimet financiare ndaj tyre bazuar në Kodin e Punës, neni 145 “*Shpërblim për vjetërsi*”.

Nga këta të larguar janë punësuar 9 punonjës, ku nga AKBN për 7 punonjës është bërë njoftimi në faqen WEB për pozicione vakante dhe është bërë procedurë konkurimi dhe emërimit të tyre. Ndërsa për D. D. nuk ka procedurë emërimi, veprime në kundërshtim me nenin 25 “*Strukturat për pranimin në punë*” të Statut-rregullores dhe Rregullores e AKBN-së, por nga AKBN është lidhur kontratë punë me afat me datë 11.04.2018.

Punonjësja ka marrë dëmshpërblim për largim nga puna në shumë e 282,695 lekë, përkatësisht në shumën e 3.5 pagave.

D. D. ka vazhduar marrëdhëniet e punës me kontrata me afat të përcaktuar deri me datën 02.03.2021, ku është emëruar me urdhrin nr. 29, datë 02.03.2021 si Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë.

2.3. Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se:

- Bazuar në VKM me nr. 833, datë 28.10.2020 “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*” paragrafi III. Regjistri Qendror i Personelit dhe Platforma e Bashkëpunimit, si dhe paragrafi vii “*Dispozita të fundit*” pika 6 “*Regjistri Qendror i Personelit, i krijuar në bazë të vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, vijon..*” rezultoi se nga institucioni nuk është

plotësuar regjistri i personelit, duke evidentuar lëvizjet e kryera brenda institucionit, lëvizjet nga një pozicion i punës në tjetrin si dhe largimet nga puna dhe marrja e punonjësve të rinj etj.

- Dosjet personale të punonjësve mbahen dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore, ku rezultoi se, në të gjithë dosjet mungonte fleta e inventarit, e cila duhet të firmoset nga vetë punonjësi dhe nga punonjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, i ngarkuar me administrimin e dosjeve personale të punonjësve, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të AKBN-së neni 26 pika 3 dhe pika 5.

- Nga auditimi i listë prezencave nga sektorët dhe drejtoritë e AKBN-së për vitin 2022 dhe vitin 2023 rezultoi se ato nuk janë firmosur dhe miratuar nga Drejtori i Administratës, znj. S. H..

- Nga auditimi i listë prezencës për muajin Shkurt, Mars, Maj, Qershor, Tetor dhe Nëntor 2020 rezultoi se: *Drejtori i Administratës ka marrë shpenzime dieta brenda vendit dhe nuk figuron në listëprezencë me Shërbim, ashtu siç deklarohet për të gjithë punonjësit, ku në datat të cilat kanë qenë më shërbim dhe janë paguar për shpenzime dieta janë shënuar në listëprezencën me shërbim.*

- Me urdhrin nr. 253, datë 31.10.2022, znj. J. S. është emëruar specialiste e parë në Sektorin e Marrëdhënieve me jashtë në Drejtorinë e Zhvillimit Strategjik dhe Dëgjësive me Publikun. Të drejtat financiare i kanë filluar me datë 01.11.2022.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosje rezultoi se kalimi nga pozicioni si asistente e Drejtorit Ekzekutiv në këtë pozicion nuk ka të bashkëlidhur ***asnjë procedurë të rekrutimit si dhe kriteret që duhet të plotësojë ky pozicion.*** Punonjësi në fjalë ka kryer studimet në Shkenca dhe Teknologji Ushqimore. Emetimi i saj në këtë pozicion është ***në kundërshtim të kriterëve dhe përshkrimin e punës që janë të përcaktuar për këtë pozicion, në*** përshkrimet e punës së punonjësve të AKBN-së.

Nga verifikimi i shpalljeve të vendeve vakante në faqen zyrtare të AKBN për këtë pozicion ndër vite rezultoi se është ***kërkuar si kriter që kandidati duhet të këtë mbaruar studimet në shkenca shoqërore dhe shkenca sociale.***

Specialisti i Parë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a. Përgatit dhe ndjek projekt-programin vjetor të shërbimeve të planifikuara për jashtë vendit mbi bazën e informacioneve të sjella nga Drejtorët e Drejtorive në AKBN;
- b. Harton Plan Buxhetin e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë;
- c. Përgatit dokumentacionin përkatës për përmbushjen me sukses e të gjitha vizitave të titullarit jashtë vendit;
- d. Mbajtja e database –it për të gjitha shërbimet jashtë vendit;
- e. Përgatit dokumentacionin përkatës për trajnimet, shërbimet zyrtare, etj;
- f. Ndjek korrespondencën me agjencitë homologe, organizmat ndërkombëtare, misionet e tyre dhe përfaqësitë diplomatike të akredituar në Shqipëri, institucione ndërkombëtare dhe investitorë të huaj, të interesuar për investime dhe nxit interesin e tyre për bashkëpunim me vendin tonë dhe informon Përgjegjësin e Sektorit;
- g. Në bashkëpunim me Specialistët në AKBN, përgatit materiale informative dhe promovuese për të prezantuar dhe promovuar veprimtaritë e tyre ekonomike, mundësitë dhe objektivat për bashkëpunim ekonomik, teknik dhe shkencor;
- h. Në bashkëpunim me Specialistët në AKBN, përgatit prezantime për zhvillimin e forumeve ndërkombëtare, seminareve të takimeve dy dhe shumë palëshe, vizitat me karakter njohës dhe të shkëmbimit të përvojave në kuadër të pjesëmarrjes nga përfaqësues të AKBN-së;
- i. Përgatit vlerësime, parashikime, përgjithësime dhe analiza në fushën e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me jashtë dhe i prezanton sipas nevojës dhe porosive të përgjegjësit të sektorit;
- j. Propozon pranë përgjegjësit të sektorit ide të reja ose ndryshime në modelet ekzistuese për të përmirësuar ose zhvilluar arritjen e objektivit të sektorit;

k. Kryen detyrat sipas planit të punës të paracaktuar nga përgjegjësi i sektorit brenda afateve kohore;

- Gjithashtu, nga auditimi i listëprezencës së muajit nëntor të vitit 2022 ku punonjësja ka marrë emërimin në “Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë” në Drejtorinë e Zhvillimit Strategjik dhe Dëgjësave me Publikun nuk është përfshire dhe deklaruar në listëprezencë të firmosur nga Drejtori i kësaj drejtorie, si dhe në asnjë drejtori apo sektor.

Sa më sipër punonjësi në fjalë është paguar për muajin nëntor për pozicionin e specialistit në “Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë” në vlerën neto prej 86,230 lekë e pa justifikuar me dokumentacionin e prezencës në punë, e cila duhet të ishte firmosur nga Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Strategjik dhe Dëgjësave me Publikun dhe nga Drejtori i Administratës.

- Nga auditimi i dosjes së punonjësit R. M. rezultoi se është emëruar me Urdhrin nr. 430, datë 07.12.2018 në pozicionin Specialiste në Sektorin e Mbështetjeve Ligjore në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore **pa procedurë rekrutimi**, veprime në kundërshtim me Statut-Rregullorja e AKBN neni 24 “Marrëdhëniet e punës” dhe të nenit 26 të Rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Mes R. M. dhe AKBN është lidhur dhe kontrata pa afat me datën 07.12.2018

- Punonjësja E. H. është emëruar me Urdhrin nr. 2845, datë 29.09.2017 në pozicionin Specialiste e Parë në Sektorin e Arkivës dhe Protokollit në Drejtorinë e Administratës **pa procedurë rekrutimi**, ku është lidhur dhe kontrata pa afat me datën 29.09.2017.

Me urdhër nr. 222 ,datë 05.04.2018 është liruar si Specialiste e parë dhe është emëruar specialiste pranë Sektorin e Arkivës dhe Protokollit në Drejtorinë e Administratës ku i fillojnë të drejtat financiare me datën 06.04.2018, **ku nuk ka shtesë kontrate të lidhur pasi kemi ulje ne kategori dhe paga është e ndryshuar.** Nga verifikimi i listëpagesave të muajit Prill 2018 e në vazhdim rezultoi se është bërë reflektimi i ndryshimit të pagës nga Specialiste e Parë në Specialiste.

Me urdhër me nr. 45, datë 05.04.2019 është liruar si Specialiste pranë Sektorin e Arkivës dhe Protokollit në Drejtorinë e Administratës dhe është emëruar në pozicionin Specialiste në Sektorin e IT dhe Dixhitalizimit, **ku është bërë shtesë kontrate për ndryshim pozicioni.**

Emërimi i E. H. në pozicionin Specialiste në Sektorin e IT dhe Dixhitalizimit është **në kundërshtim të kriterëve, (ku minimalisht kandidati duhet të këtë mbaruar shkenca kompjuterike ose ekuivalente) dhe përshkrimin e punës që janë të përcaktuar për këtë pozicion. Punonjësja në fjalë është e diplomuar për Shkenca Sociale.**

Në përshkrimet e punës së punonjësve të AKBN-së është përcaktuar se Sektori i IT dhe Dixhitalizimit, si pjesë përbërëse në strukturën e Dr. Administratës ka si mision të kryejë përmbushjen e detyrave dhe sigurimin e mbështetjes së specializuar ne fushën e IT-së për punonjësit e AKBN-së, ku

Specialisti ka këto detyra dhe përgjegjësi;

- a. Instalimin e software-ve të ndryshme.
- b. Mirëmbajtjen e software-it të AKBN-së.
- c. Mirëmbajtjen e llogarive të përdoruesve .
- d. Konfigurimin e Email-it të brendshëm të AKBN-së.
- e. Përmbush detyra të ndryshme që dalin gjatë punës sipas udhëzimeve të Shefit të Sektorit të IT.
- f. Suportin teknik te website-t zyrtar të institucionit.
- g. Back-up i sistemeve dhe të dhënave dixhitale të institucionit.

2.4. Nga auditimi i kalimit nga një kategori punësimi në një pozicion tjetër rezultoi se:

Nga AKBN është bërë kalimi nga specialist në Sektorin e Mbështetjeve Ligjore në Shefe Sektori për punonjësën znj. M. G..

Punonjësi është emëruar si specialiste në sektorin e mbështetjes ligjore me datën 02.11.2022, e cila është bërë pas kërkesës së drejtorit të drejtorisë së shërbimeve ligjore me datë 24.10.2022 për plotësimin e vendeve vakante në këtë drejtori.

Nga AKBN është bërë publikimi i njoftimit në faqen zyrtare me shkresën nr. 4662/1 të datës 24.10.2022 për shpalljen e vendit vakant për pozicionin e specialiste në Sektorin e Mbështetjes Ligjore në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore.

Në procesverbalin e mbajtur me datën 31.10.2022 nga komisioni Ad Hoc me përbërje drejtori i Drejtorisë përkatëse, Drejtori i Administratës dhe Shefi i Sektorit të Burimeve Njerëzore është shpallur fituese znj. M. G., e cila është emëruar më urdhrin me nr. 256 prot., 4462/4 datë 01.11.2022 dhe lidhur kontrata me datë 02.11.2022.

Me urdhrin nr. 103, datë 22.05.2023 (prot., 2567) është bërë emërimi nga pozicioni Specialiste në Shefe Sektori në Sektorin e Mbështetjes Ligjore, **pa asnjë procedurë**, duke u bazuar vetëm në një e-mail të Drejtorit të Drejtorisë që propozon plotësimin e vendit vakant të shefit të Sektorit. Me datën 23.05.2023 është bërë shtesë kontrate për kalim shefe sektori.

-Nga AKBN është bërë kalimi i punonjësit A. H. nga specialist në sektorin e Arkivës në Shef Sektori. A. H. ka lidhur kontratë pune me afat të përcaktuar me AKBN me datën 07.01.2019, pas një kërkesë të Shefes së Sektorit të Arkiv Protokoll, ku kërkon që për të përballuar fluksin e punës në këtë sektor kërkon mundësinë e punësimit të një punonjësi me kontratë. Bashkëlidhur nuk ka **asnjë procedurë përzgjedhje dhe kriteret që duhet të plotësojë punonjësi për këtë pozicion.**

Punonjësi është emëruar si specialiste në sektorin e Arkiv Protokollit me datën 05.04.2019, ku është lidhur kontratë pune pa afat.

Personi i emëruar ka mbaruar studimet për Mësues i Edukimit Fizik. Në praktikat e punësimit për këtë pozicion pune si kriter është “Të ketë mbaruar studimet universitare në Shkenca Shoqërore”.

Me urdhrin nr. 183, datë 30.08.2022 (prot., 3698) është bërë emërimi nga pozicioni specialist në shef sektori në Sektorin Arkivë- Protokoll, në Drejtorinë e Administratës, pa asnjë procedurë, duke lidhur shtesë kontrate mes palëve me datë 07.09.2022.

Me shkresën nr. 627, datë 22.01.2024 drejtuar Drejtorit Ekzekutiv dhe për dijeni Drejtorit të Administratës, nga Z.H. është kërkuar ndryshimi i pozicionit nga Shef sektori në një pozicion tjetër brenda sektorit.

Me urdhrin nr. 8 datë 25.01.2024 është bërë ndryshimi nga Shef Sektori në Specialist i Parë në Sektorin e Arkivës Administrative dhe Protokoll për punonjësin A. H..

Për periudhën tetor -dhjetor 2022 Shefi i Arkivës Administrative dhe Protokoll ka qenë me raport mjekësor për periudhë të gjatë kohore dhe Listëprezencat e këtij sektori janë firmosur në emër të tij nga përgjegjësi i sektorit.

Sa më sipër, nga grupi i auditimit u konstatua se përgjatë gjithë kësaj periudhe nuk ka asnjë urdher për delegim kompetencash.

Më vitin 2022 janë bëra kalime nga specialist në shef sektori pa procedurë dhe pa kërkesa bashkëlidhur sipas përcaktimit të Neni 27 “Lëvizjet paralele dhe uljet apo ngritjet në detyrë” të Rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për A. H. nga specialist në Shef Sektori me datë emërimi 20.12.2022 dhe A. L. nga specialist në Shef Sektori me datë emërimi 25.10.2022.

Konkluzion:

Sa më sipër konstatohet se emërimet, kalimet nga një kategori në tjetrën të punonjësve (ku një pjesë e lëvizjeve janë nga specialist në shefe sektori, pa kaluar më parë Specialist i parë) janë të pa bazuar në një vlerësim performace të stafit, pasi në AKBN për vitet me radhë nuk është bërë asnjë vlerësim performace për stafin.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe manualin e MFK-

së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm” ku përcakton qartë se:

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
- Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Një *sistem për vlerësimin e performancës* që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon *me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për:*

- Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune;
- Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës;
- *Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta etj.*

- Si dhe me Nenin 10 “Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë” të Rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore pika k “Zbaton sistemin e vlerësimit të punonjësve të drejtorisë së tij, në fillim të muajit dhjetor të çdo viti”.

2.5. Emërimet e përkohshme:

Nga auditimi i kalimit nga një kategori punësimi në një pozicion tjetër rezultoi se:

Nga AKBN është bërë kalimi i punonjësës M. H. nga specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Shefe Sektori. Nga AKBN është bërë publikimi i njoftimit në faqen zyrtare me shkresën nr. 4085, datë 30.10.2020 për shpalljen e vendit vakant për pozicionin e specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Administratës. Në procesverbalin e mbajtur me datën 05.11.2020 nga komisioni Ad Hoc me përbërje drejtori i Drejtorisë së Administratës dhe dy specialistë nga Sektorin e Burimeve Njerëzore, është shpallur fituese znj. M. H., e cila është emëruar më urdhrin me nr. 111 prot., 4085/3, datë 05.11.2020 dhe lidhur kontrata me datë 05.11.2020.

Me urdhrin nr. 94, datë 01.07.2021 (prot., 2538) është bërë emërimi nga pozicioni Specialiste në Specialiste e parë e Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Administratës.

Me urdhrin nr. 27, datë 24.02.2022 (prot., 1116/1) është bërë emërimi nga pozicioni Specialiste e Parë në shefe Sektorit e Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Administratës, ku është cituar se është emërim i përkohshëm, dhe në pikën 2 të këtij urdhëri citohet se të drejtat financiare fillojnë me datën 25.02.2022.

Punonjësja ka marrë *emërim të përkohshëm pa afat të caktuar* në urdhër (komanduar) dhe si rrjedhojë nuk duhet të ndryshojnë të drejtat financiare për periudhën nga data 25.02.2022 deri me datën 27.05.2023. Me Urdhrin nr. 104, datë 22.05.2023 është shfuqizuar urdhri i emërimit të përkohshëm si Shefe Sektori.

-Me urdhrin nr. 113, datë 03.06.2022 (prot., 2426/1) është bërë emërimi i z. M. M., nga detyra Specialist i Parë në Shef Sektorin në Sektorin e Procedurave dhe Trajtimit të Ankesave në Drejtorinë e Monitorimit të Hec-ve, ku është cituar se është emërim i përkohshëm, dhe ky emërim është deri në rikthimin në punë nga leja e barrë lindjes së Shefit të Sektorit. Në pikën 3 të urdhrit citohet të drejtat financiare fillojnë me datën 06.06.2022, të cilat kanë vazhduar deri me datën 24.04.2023.

Sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi se punonjësi ka marrë emërim të përkohshëm në urdhër, (komanduar) dhe si rrjedhojë nuk duhet të ndryshojnë të drejtat financiare.

-Me urdhrin nr. 5, datë 25.01.2022 (prot., 454/2) është bërë emërimi i znj.B. B., nga detyra Specialist i Parë në Sektorin e Auditimit të Marrëveshjeve Hidrokarbureve në Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, ku është cituar se emërohet përkohësisht edhe Drejtor i Drejtorisë Ekonomike. Në pikën 2 të urdhrin citohet të drejtat financiare fillojnë me datën 26.01.2022.

Punonjësjka ka marrë emërim të përkohshëm pa afat të caktuar në urdhër (komanduar) dhe si rrjedhojë nuk duhet të ndryshojnë të drejtat financiare për periudhën nga data 26.01.2022 deri me datën 23.05.2022, ku është bërë emërimi me urdhrin nr. 104, datë 23.05.2022 për emërimin në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Administratës.

Me datën 27.02.2023, ku znj. B. ka kërkuar largimin nga puna, i cili është miratuar nga Drejtori Ekzekutiv, me anë të urdhrin nr. 37 datë 27.02.2023.

3. Procedurat e prokurimit blerje e vogël:

3.1. Nga auditimi i komisioneve të ngritura nga titullari i institucionit për procedurat e blerjeve të vogla dhe sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar rezultoi se:

Për vitin 2022 në përbërje të komisionit janë Drejtori i Administratës, kryetar dhe anëtar një specialist nga Sektori i Mbështetjes Ligjore dhe një Specialist nga Drejtoria e Monitorimit të HEC-ve. Për vitin 2023 në përbërje të komisionit janë Drejtori i Administratës, kryetar dhe anëtar një specialist nga Sektori i Mbështetjes Ligjore dhe Shefi i Sektorit të prokurimeve dhe Kontratave.

Për vitin 2022 nga AKBN janë planifikuar për tu realizuar vetëm procedura blerje e vogël dhe vetëm një procedurë e hapur e thjeshtuar për “Blerje karburanti”, Dy procedura të hapura janë të planifikuara dhe realizuara nga AKSHI.

Për vitin 2023 nga AKBN janë planifikuar për tu realizuar vetëm procedura blerje e vogël dhe vetëm një procedurë e hapur e thjeshtuar për “Blerje karburanti”. Dy procedura të hapur janë të planifikuara dhe realizuar nga AKSHI.

Konkluzion:

Në statut rregulloren e AKBN-së në nenin 18/3 përcakton se: Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore/Sektorit i Prokurimeve dhe Kontratave në pikën 5 citon se *“Të realizojë procedurat e prokurimit në zbatim të dispozitave ligjore shqiptare për prokurimin publik dhe të hartojë dhe monitorojë kontratat me të tretët, duke siguruar transparence dhe barazi për të gjithë operatorët ekonomikë dhe palët kontraktore”*

Dispozita e statut rregullore bie në kundërshtim me nenin 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* ku përcaktohet se *“Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar”*.

Sa më sipër rekomandohet marrja e masave të menjëhershme mbi përditësimin e statut rregullore në përputhje të ligjit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore në zbatim.

Referuar statut rregullore, kjo drejtori nuk ka realizuar detyrat funksionale të përcaktuara në të pasi *procedurat e prokurimit janë realizuar nga punonjës të strukturave të tjera, e cila ka ardhur si pasojë e komisioneve të ngritura nga Titullari i institucionit, si dhe mospërputhja e statut rregullore me Ligjin dhe VKM-në për prokurimin publik.*

Nga auditimi i blerjeve të vogla për vitin 2022-2023 rezultoi se:

Në përbërje të komisionit është Drejtori i Administratës, në rolin e kryetarit të komisionit.

- Të gjitha kërkesat për nevoja për mallra e shërbime janë drejtuar Drejtorit të Administratës për nisjen e procedurave të prokurimit, e cila është e përcaktuar dhe në përshkrimet e punës së AKBN-së dhe në detyrat funksionale që ka drejtori i kësaj Drejtorie.

- Në procesverbalin e përlogaritjes së fondit limit citohet se referuar kërkesës drejtuar Drejtorit të Administratës për fillimin e procedurës së prokurimit, bën përlogaritjen e fondit limit.

Konkluzion: Sa më sipër konstatohet se në të njëjtën kohë Drejtori i Administratës është dhe Kryetar i komisionit të blerjeve të vogla, i cila miraton kërkesat për nevojat dhe zhvillon procedurat e prokurimit, si dhe merr në dorëzim mallrat/shërbimit në rolin e komisionit të marrjes në dorëzim të tyre.

Në asnjë vit nga titullari i Institucionit nuk është ngritur urdhër për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku në pikë 42 përcakton se: *Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues*” dhe pika 43 ku përcakton se “*Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të punëgjegjësi materiale*”.

- Referuar urdhrin me nr. 31, (prot. 2149) datë 07.02.2018, S. H., Drejtori i Administratës është pjesë e “Njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizueseve.”

Konkluzion: Sa më sipër kemi mospërputhshmëri të funksionit të S. H. pasi nuk mund të jetë njëkohësisht dhe Drejtorë Administrate dhe kryetare komisioni blerjesh dhe në të njëjtën kohë dhe sinjalizuese.

Pasi bazuar në rregulloren e AKBN dhe përkrahjet e punës së AKBN-së është përcaktuar se: Drejtori i Drejtorisë së Administratës një ndër detyrat e përcaktuara janë:

- Bashkërendon dhe mbikëqyr punën e të gjithë Sektorëve që mbulon, lidhur me hartimin, realizimin dhe zbatimin e detyrave të Drejtorisë përkatëse dhe veprimtarisë të AKBN në përgjithësi;
- Përgjigjet për mbarëvajtjen e punës së punonjësve të drejtorisë, si dhe bën vlerësimin e punës së tyre;
- Propozon tek Drejtori Ekzekutiv marrjen e masave disiplinore për rastet e shkeljes së disiplinës dhe etikës në institucion, si dhe raste të tjera, të përcaktuara nga legjislacioni i punës dhe nga Statut-rregullorja e funksionimit të AKBN-së;
- Bashkëpunon me strukturat përkatëse për planifikimin e nevojave për furnizimin me materiale të ndryshme në institucion.
- Propozon për miratim tek Drejtori Ekzekutiv përmirësimin dhe ndjekjen e rregullave dhe procedurave të pranimit, fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës së personelit në AKBN.
- Bashkërendon punën për zhvillimin e strategjisë së planifikimit të Burimeve Njerëzore, dhe monitoron progresin dhe produktivitetin e punonjësve të AKBN-së.
- Sugjeron tek Drejtori Ekzekutiv ndryshime apo përmirësime në rregulloren e brendshme të AKBN në lidhje me disiplinën dhe etikën e punonjësve.

3.2. Nga verifikimi i procedurave të prokurimit si mëposhtë rezultoi:

- Për procedurën blerje “*Bojë printeri*” të zhvilluar me datë 13.05.2022 në vlerën 574,668 lekë rezultoi se nga Komisioni i blerjeve të vogla është mbajtur procesverbali me datë 17.05.2022 i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i pari në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 18.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i dyti në OE pasardhës me arsyetimin e mosparaqitjes së tij brenda afatit të përcaktuar dhe mos njoftimit në SPE.

Me datë 19.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i treti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 20.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i katërti në OE pasardhës me arsyetimin e mosparaqitjes së OE.

Me datë 23.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i pesti në OE pasardhës me arsyetimin e mosparaqitjes së OE.

Me datën 24.05.2022 janë marrë dokumentacioni nga OE i shpallur fitues për të vërtetuar nëse plotëson kriteret e kërkuar në ftesën për ofertë.

Po me datën 24.05.2022 nga Komisioni blerjeve të vogla është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar.

Sa më sipër nga grupi i auditimit rezultoi se Kryetarja e Komisionit znj. S. H., e cila ka firmosur procesverbalet për datat 17.05.2022-20.05.2022 është me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së nga data 16.05.2022-20.05.2022, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta. Sa më sipër, është e pamundur që një person të jetë njëkohësisht prezent në dy vende.

- Për procedurën blerje “Goma Makine” të zhvilluar me datën 12.05.2022 në vlerën 574,668 lekë

rezultoi se nga Komisioni i blerjeve të vogla është mbajtur procesverbali me datë 16.05.2022 i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i pari në OE pasardhës me arsyetimin se OE nuk plotëson kriteret e kërkuar në ftesën për ofertë.

Me datë 18.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i dyti në OE pasardhës me arsyetimin tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 19.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i treti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 20.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i katërti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 23.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i pesti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura..

Me datë 24.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i gjashti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 26.05.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët, ku citojnë se me datën 24.05.2022 dy OE e renditur në vend të shtatë të cilët kanë ofertë të njëjtë janë njoftuar për tu paraqitur për të hedhur shortin. OE H. G.... C.... ka njoftuar për tërheqjen ndërsa OE E.... Z..... nuk ka njoftuar dhe nuk është paraqitur, ku Komisioni vendosi kalimin dhe njoftimin e OE të radhës renditur në vendin e nënte B.... M.....

Me datën 30.05.2022 nga Komisioni blerjeve të vogla është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar.

Sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi se Kryetarja e komisioni znj. S. H., e cila ka firmosur procesverbalet për datat 16.05.2022-20.05.2022 është me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së nga data 16.05.2022-20.05.2022, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta. Pra është e pamundur që një person të jetë njëkohësisht prezent në dy vende.

- Për procedurën blerje “Pajisje Kondicionimi” të zhvilluar me datën 04.11.2022 në vlerën 436,800 lekë rezultoi se: nga Komisioni i blerjeve të vogla është mbajtur procesverbali me datë 04.11.2022 i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i pari në OE pasardhës me arsyetimin se OE nuk u paraqit dhe nuk ka njoftuar ne SPE.

Me datë 07.11.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i dyti në OE pasardhës me arsyetimin se nuk plotëson specifikimet

e kërkuar në ftesën për ofertë pasi nga AK është kërkuar kondicioner kollonë 60000 BTU, ndërsa OE ka ofertuar kondicioner 55000 BTU.

Me datë 07.11.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i treti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 08.11.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i katërti në OE pasardhës me arsyetimin e mosparaqitjes së OE dhe mos njoftimit në SPE.

Me datë 09.11.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i pesti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 10.11.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i gjashti në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura.

Me datë 11.11.2022 nga Komisioni është mbajtur procesverbali i firmosur nga anëtarët për kalimin nga OE i renditur i shtati në OE pasardhës me arsyetimin e tërheqjes së OE nga procedura, në vendin e tetë Elvis Hajdëraj në vlerën 364,000 lekë pa tvsh.

Me datën 17.11.2022 nga Komisioni blerjeve të vogla është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, ku citojnë se malli i marrë është sipas specifikimeve në ftesën për ofertë dhe është dorëzuar në magazinë.

Në procesverbal nuk është konfirmuar dhe nuk ka asnjë komision që vërteton nëse OE ka plotësuar kushtet e përcaktuar në ftesën për ofertë, ku thuhet se “në çmim duhet përfshirë dhe instalimi dhe duhet parashikuar edhe distanca e tubave prej 15 metra”.

Sa më sipër nga grupi i auditimit rezultoi se:

- Kryetari e komisionit znj. S. H., i cili ka firmosur procesverbalet për datat 08.11.2022-11.11.2022 është me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së nga data 08.11.2022-11.11.2022, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta. Pra është e pamundur që një person të jetë njëkohësisht prezent në dy vende.

- Komisioni marrjes në dorëzim të mallrave është i njëjtë me komisionin e Blerjeve të vogla me përbërje Drejtorin e Administratës S. H., A. B. dhe D. M. veprime në kundërshtim me LPP, si dhe në përbërje të grupit nuk ka asnjë specialist fushe për të verifikuar nëse malli i porositur është konform kërkesave dhe mungon relacioni në lidhje me instalimin e kësaj pajisje, që ka qenë detyrim i subjektit fitues.

- Nga auditimi i “Blerjes së pajisjeve për kamera sigurie” është bërë procedurë emergjente.

Në dosje nuk ka asnjë formular për përlllogaritjen e fondit limit, mbi të cilën të vërtetohet se fondi është nën vlerën 100,000 lekë. Gjithashtu nga Komisioni nuk është mbajtur formulari nr. 4, siç është përcaktuar në Udhëzimin me nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 20.

Me kërkesën nr. 5096/1, datë 16.12.2022 drejtuar Drejtorisë së Administratës për blerje komerash nga Sektori i IT dhe Dixhitalizimit.

Nga Komisioni i blerjeve të vogla nuk është marrë konfirmim nga Drejtoria e Financës mbi fondet në dispozicion për realizimin e procedurës. Referuar faturës tatimore me nr. 11235/2022 datë 19.12.2022 është realizuar blerja tek subjekti P. S.....

Bashkëlidhur nuk ka asnjë dokumentacion mbi marrjen në dorëzim të kamerave, si dhe procesverbal mbi instalimin e tyre, vetëm fletëhyrja e mallrave në magazinë me datë 19.12.2022, dhe fatura e blerjes së mallrave, e cila është firmosë nga Komisioni i blerjeve të vogla.

Nga Komisioni i blerjeve të vogla është dërguar fatura dhe fletë hyrja e mallrave në magazine me nr. 15, datë 19.12.2022, drejtorisë ekonomike për vazhdimin e likuidimit të OE.

Nga Drejtoria e Financës me shkresën nr. 5096/3 dhe 5096/5, datë 28.12.2022 është kundërshtuar blerja me faktin se në buxhetin e miratuar për vitin 2022-2024 nuk ka të miratuar

fonde për investime, dhe blerja e kamerave janë asete për institucionin, ku i është drejtuar dhe me memon nr. 5096/7, datë 30.12.2022 Drejtorit të AKBN, për pamundësinë e realizimit të kësaj procedure. Sa më sipër realizimi i procedura është në kundërshtim të Udhëzimit me nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Konkluzioni: Sa më sipër rezulton se, Kryetari i komisionit znj. S. H., i cili ka firmosur procesverbalet për datat sipërcituara ka qenë me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta. Pra është e pamundur që një person të jetë njëkohësisht prezent në dy vende.

Gjithashtu, nga auditimi i listë prezencës për muajin Shkurt, Mars, Maj, Qershor, Tetor dhe Nëntor 2022 rezultoi se: Drejtori i Administratës ka marrë shpenzime dieta brenda vendit dhe nuk figuron në listëprezencë me Shërbim, ashtu siç deklarohet për të gjithë punonjësit, ku në datat të cilat kanë qenë më shërbim dhe janë paguar për shpenzime dieta janë shënuar në listëprezencën me shërbim.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 159/4, datë 15.04.2024, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 866/, datë 17.05.2024, protokolluar në KLSH me nr. 159/6 prot., datë 20.05.2024, ku janë shprehur Komente/shpjegime si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: Në lidhje me rekomandimet masa organizative nga AKBN janë pranuar si rekomandim, ku citojnë se kanë filluar procedurat për zbatimin e tyre.

Në lidhje me rekomandimin B.2 “masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike” sqarojnë se: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nuk financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nuk administron fonde publike, por për shërbimet që ofron siguron te ardhura mbi bazën e te cilave ushtron veprimtarinë e saj. Duke qene se te ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë se saj janë reduktuar ndjeshëm, AKBN është vendosur ne vështirësi financiare. Për zgjidhjen e kësaj situate AKBN është angazhuar plotësisht ne bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjish për hartimin e një strategjie afatgjatë, qe konsiston ne projektimin dhe implementimin e masave për përmirësimin e performances financiare te institucionit, e cila do te shmange përsëritjen e një situate te tille ne te ardhmen. Gjithashtu, bazuar ne Kodin e Punës se Republikës se Shqipërisë, neni 124 pika 2 "N° rast paaftësie pagues, detyrimet e punëdhënësit ndaj punëmarrëse kane përparësi ndaj të gjitha detyrimeve te tjera...". Ne përputhje me ketë dispozite AKBN ka paguar pagat e punonjësve dhe me përmirësimin e situatës financiare do te vijoje me shlyerjen e detyrimeve te sigurimeve dhe TAP.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje se “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nuk financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nuk administron fonde publike”, **observimi nuk merret në konsideratë** pasi të ardhurat që krijohen nga AKBN janë fonde publike dhe jo janë fonde të administruar nga një kompani private.

Sa më sipër grupi i auditimit do vlerësojë zbatimin e rekomandimeve. në auditimin e radhës ose në zbatimin e rekomandime mbas 6 muajsh.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, ku kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, ku nga ana Juaj të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me datë 15.05.2024, protokolluar në KLSH me nr. 159/5 prot., datë 15.05.2024, ku janë shprehur Komente/shpjegime të S. H. si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit: - Për tre procedurat e blerjeve të vogla në SPE (Bojë printeri, Blerje goma makine, Pajisje Kondicionimi), ku Drejtori i Administratës ka qenë me autorizim jashtë qendrës së punës dhe nga ana tjetër janë firmosur dokumentacioni përkatës në ato data, sqarojmë se e gjithë procedura është kryer online nëpërmjet sistemit elektronik nëpërmjet faqes së APP nga i gjithë Komisioni i Blerjeve të Vogla duke qenë se procedura duhet të kryhet njëkohësisht nga të tre anëtarët;

-Edhe ne Nenin 10, Sinjalizimi i brendshëm dhe njësite përgjegjëse, ne piken 2 thuhet se, Njësia përgjegjëse mund të përbehet nga një ose me shumë persona, sipas përbërjes dhe strukturës së organizatës, të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve, pa dhënë ndonjë specifikë konkrete lidhur me pozicionet e personave që duhet të jene ne Njësinë përgjegjëse. Për këtë rast nuk mund të themi se ka ndonjë shkelje pavarësisht edhe detyrave të parashikuara ne Rregulloren e AKBN apo ne Përshkrimet e punës duhet të kryej Drejtor i Administratës;

- Sa i takon procedurave të rekrutimit në të gjitha këto procedura bazuar në nenin 26 është zbatuar pasi Komiteti ad hoc, në përbërjen e të cilit është gjithmonë Drejtori përkatës i cili bën kërkesën me specifikime dhe kriteret të veçanta si dhe Drejtori i Administratës dhe Shefi i Sektorit të burimeve njerëzore të cilët përcaktojnë me shkrim në relacionin drejtuar titullarit subjektet e testimi dhe mënyrën e vlerësimit sipas komisionit. Vlerësimi i cili është here gjithmonë në bazë të kriterëve të vendosura nga drejtoritë përkatëse dhe dokumentacioni i dorëzuar nga aplikonte. Pika 2 neni 26 nuk përcakton në asnjë moment mënyrën e me sistem pikëzimi. Gjithashtu Drejtorja e Administratës, sektori i burimeve njerëzore është dhe duhet të jete patjetër pjesë përbërëse e komitetit ad hoc pasi e ka edhe detyrë funksionale përzgjedhjen e kandidatëve. Përshkrimet e punës 4.2 citon: Shefi sektorit të burimeve njerëzore pika 1. Merr pjese ne procesin e intervistomi te kandidatëve të përzgjedhur në bashkëpunim me Drejtoret e Drejtorive

-Sa i takon realizimit të procedurave blerje e vogël të cilat realizohen online, në material është trajtuar që kryetari e komisionit ka qenë me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta, dhe është e pamundur që një person të jetë njëkohësisht prezent në dy vende dhe të siglojë proces verbalet e mbajtura në datën që ka rezultuar me shërbim.

Së dyti sipas metodologjisë së përdorur nga AKBN për mbajtjen e listëprezencave, ku punonjësit të cilët kanë qenë me shërbim jashtë qendrës së punës dhe është shënuar në listëprezencë me shërbim për ato ditë, (ku sipas S. H. është për efekt të zbritjes se shpërblimit ne formën e pagës në natyrë në masën 300 lek/dite), për ditët që S. H. ka qenë me shërbim, kjo nuk është shënuar dhe reflektuar në listëprezencë, njësoj si për punonjësit e tjerë, kjo vërtetuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore, grupit të auditimit në punën audituese në terren.

- Së treti nga grupi është kërkuar check-in i punonjëses në fjalë për vitet 2021-2023, ku në sistemin e check-in të AKBN nuk figuronte të kishte bërë check-in e kartës në asnjë ditë pune.

-Sa i takon sinjalizimi i brendshëm dhe njësite përgjegjëse rezulton se mospërputhje e funksioneve dhe konflikt mes tyre, ashtu siç është trajtuar dhe në material. Për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk paraqet dokumentacion shtesë.

- Sa i takon procedurave të rekrutimit, duke qenë se Shefi i sektorit të burimeve njerëzore bën përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë për plotësimin e kriterëve të kërkuara me dosjen e dorëzuar të aplikantit, rrjedhimisht nuk mund të jetë pjesë e komitetit ad hoc të përzgjedhjes së kandidatëve. Observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk paraqet dokumentacion shtesë.

Bazuar në kërkesën e S. H. “Për takimin e mirëkuptimit me grupin e auditimit në lidhje me auditimin e zhvilluar ne AKBN” datë 24.05.2024, protokolluar në KLSH me nr.159/7, datë 24.05.2024, në ambientet e KLSH-së me datë 29.05.2024 në orën 9⁰⁰, u zhvillua takimi mes grupit të auditimit dhe znj. H., ku u diskutua në lidhje me observimet e dërguara nga ana e saj dhe gjetjet e konstatuara nga grupi në terren dhe reflektuara në projekt raportin e auditimit.

5. Largimet nga puna

Nga auditimi i dosjeve të largimit të stafit rezultoi se në 11 largime nga puna kanë ardhur si shkak i përfundimit/zgjidhjes së kontratës për arsye të cilat lidhen me vështirësinë financiare të institucionit.

Në 4 largimet janë shkëputja e marrëdhënieve për punonjës me kontratë më afat të cilat janë lidhur **me datën 29.12.2023.**

Në komisionin për përgatitjen dhe ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore me punonjësit për të cilit është parashikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka qenë S. H., Drejtore e Administratës, B. P. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore dhe M. H. Specialiste e parë në Drejtorisë së Administratës.

Konkluzion: Sa më sipër rezulton se ri-lidhjet e kontratave të këtyre punonjësve janë bërë në kushtet kur AKBN ka qenë në vështirësi financiare pasi kishte që nga muaji nëntor 2023 që nuk paguante pagat e stafit, ndërkohë nga AKBN janë marrë iniciativat për rilidhjen e kontratave, e cila është përgjegjësi direkte e menaxhimit të institucionit.

Në njoftimin për zgjidhjen e kontratës është cituar se mbështetur në nenin 141 e vijues të Kodit të Punës të RSH. Këta punonjës kanë qenë me kontratë me afat dhe nuk jemi në kushtet e nenit 141 “Zgjidhja”, ku përcakton “Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit”.

Gjithashtu thuhet se në përfundim të marrëdhënieve të punës, ju do të përfitoni shpërblim për vjetërsinë në punë, si dhe pagesë për pushimet e pamarrë, pasi tre nga punonjësit kanë mbi 3 vite të cilët kishin kontratë me afat të përcaktuar.

Të katër punonjësit me kontratë me afat janë jashtë numrit të miratuar të strukturës dhe kanë mbi një periudhë tre vjeçare që qëndrojnë me kontratë me afat.

Në lidhje me punonjësën E. Gj. specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Strategjik dhe Dëgjësave me Publikun dhe E. J. specialist në Drejtorinë e Energjisë së Rinovueshme u konstatua se: Pasi nga AKBN bazuar në nenin 144/1,2,3 të Kodit të Punës ka njoftuar me shkrim punëmarrësin dhe pas realizimit të takimit mes palëve, ku nga komisioni është mbajtur procesverbali për diskutimin e marrëdhënieve të punës me punëmarrësin, punëmarrësit janë shprehur se nuk janë dakord për zgjidhjen e kontratës.

Nga auditimi i dosjes rezulton nga AKBN nuk është njoftuar zgjidhja me shkrim brenda një afati prej 48 orësh deri në një javë pas takimit punonjësit në fjalë sipas përcaktimeve të bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës, as urdhër për vazhdimin e marrëdhënieve të punës. Nga Drejtoria e Burimeve njerëzore, grupit të auditimit i është komunikuar se është në proces.

Për pesë punonjësit e tjerë të larguar, katër prej tyre e kanë kundërshtuar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe një nga punonjësit z. R. M. nuk është paraqitur edhe pas njoftimit nga komisioni për marrjen pjesë në takim dhe mbledhjes tre here të komisionit për ti komunikuar arsyen e shkëputjes së marrëdhënieve të punës.

Konkluzion: Sa më sipër, nga AKBN bazuar në nenin 144/1,2,3 të Kodit të Punës punëdhënësi ka njoftuar me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit. Nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06.02.2024 “Për ngritjen e komisionit për përgatitjen dhe ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore me punonjësit për të cilin është parashikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës” me anëtar B. P., Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore, M. H., Specialiste e Parë në Drejtorinë e Administratës, A. A. Specialiste e Drejtorisë së Administratës, H. Z. Specialiste e Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore dhe E. Ll. Specialist në Drejtorinë e shërbimeve ligjore, janë mbajtur procesverbali për diskutimin për marrëdhënien e punës me punëmarrësin ku gjatë bisedës, janë parashtruar arsyet e vendimit të parashikuar për zgjidhjen e kontratës, ku në qëndrimin e tyre punëmarrësit janë shprehur se nuk janë dakord për zgjidhjen e kontratës.

Në procesverbalet e mbajtura dhe në takime kanë marrë pjesë dhe kanë firmosur vetëm katër anëtarë. B. P., Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore i cili është pjesë e komisionit nuk ka marrë pjesë në takime dhe nuk ka firmosur asnjë procesverbal, duke mos dhënë dokortësinë apo mosdakortësinë në lidhje me procedurën.

Gjithashtu, nga AKBN është njoftuar zgjidhja me shkrim brenda një afati prej 48 orësh deri në një javë pas takimit, ku është cituar se marrëdhëniet e punës dhe ato financiare ndërpritën në datën. X. 05.2024.

Gjithashtu thuhet se në përfundim të marrëdhënieve të punës, ju do të përfitoni shpërblim për vjetërsinë në punë, si dhe pagesë për pushimet e pamarrë, **duke i shkaktuar buxhetit të AKBN-së kosto ekstra financiare.**

Ku bazuar në nenin 145 “Shpërblimi për vjetërsinë”, ku e përcakton qartë “Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet”. *Punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm, për shkaqe të arsyeshme.*

Konkluzion: Nga auditimi i dosjes për 3 punonjësit e larguar rezultoi se:

Në asnjë rast nuk janë përcaktuar shkaqet e justifikuara të largimit nga puna sipas përcaktimit të nenit 153 të Kodit të Punës, ku konsiderohen si shkaqe të justifikuara rastet kur: a) punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, dhe b) me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, megjithëse paralajmërimet me shkrim të punëdhënësit.

Nga një interpretim logjik i dispozitës përcaktohet parimisht se dy janë kushtet kryesore për t’u plotësuar që zgjidhja e kontratës të jetë e rregullt dhe e justifikuar: *kushtet subjektive dhe kushtet objektive.*

Kushtet subjektive, lidhen me qëndrimin subjektiv, shkeljen e raportit të mirëbesimit ndaj punëdhënësit, i cili në çdo kohë, për çfarëdolloj rrethane, mjafton që të mos jetë abuzive, mund të zgjidhë kontratën e punës me punëmarrësin në mënyrë të menjëhershme. *Kushti subjektiv* nuk mund të qëndrojë i vetëm, por duhet të jetë bashkërisht me kushtin objektiv që gjen veprim/rrjedhim në pikën 3 të këtij neni. Që zgjidhja e kontratës të jetë e justifikuar duhet që elementët e nenit 153 të përmbushen njëherazi. Mospërmbushja e njërit prej këtyre kushteve nuk çënon vlefshmërinë e zgjidhjes së kontratës, por e cilëson atë si të pajustificuar: a) punëmarrësi të ketë shkelur një detyrim kontraktor shkelja të jetë kryer me faj të rëndë ose të lehtë në mënyrë të përsëritur dhe pas një paralajmërimi; b) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis shkeljes dhe zgjidhjes së menjëhershme të kontratës; c) shkelja të ketë cenuar raportin e besimit midis palëve kontraktuese.

Sa më sipër, në lidhje me largimet nga puna, të cilat janë zgjidhjet e njëanshme të kontratave të punës dhe të paargumentuara sipas Kodit të Punës, do të shkaktojnë dëm ekonomik të mundshëm për proceset gjyqësore, të cilat mund të iniciohen nga punonjësit e larguar pa shkaqe të justifikuara”.

Në procesverbalet e mbajtura me punonjësit për të cilët është bërë procedura e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës është cituar se arsyeja është për vështirësinë financiare që ka institucioni.

Nga ana tjetër nga AKBN janë realizuar procedura rekrutimi, ku me datën 23.01.2024 është bërë emërimi i një specialisti në Sektorin e Mbështetjes Ligjore dhe me datën 02.02.2024 është bërë emërimi i një Shef Sektori në Sektorin e Promovimit të Investimeve të reja dhe fondit të të dhënave teknike në drejtorinë e Hidrokarbureve.

- Me Urdhrin me nr. 27, datë 26.02.2024 është bërë shkëputja e menjëhershme të marrëdhënieve të punës të z. R. I. me detyrë Specialist në Sektorin e Përrjashtimit të TVSH-së në Drejtorinë e Procedurave Hidrokarbureve.

Në Pikën 2 përcaktohet se ndërprerja e marrëdhënieve financiare bëhet me datën 26.02.2024.

Në Pikën 3 përcaktohet se gëzon të drejtën për shpërblimet për pushimet e pamarra.

Me datën 20.02.2024, nga R. I. është paraqitur me e-mail zyrtar Titullarit të Institucionit kërkesa për dorëheqje, ku është kërkuar ndërprerja e marrëdhënies të punës sipas dispozitave ligjore ne fuqi. Kërkesa nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është bërë pjesë e dosjes.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës është e menjëhershme, por nga AKBN nuk është respektuar neni 144 i Kodit të punës pika 4 ku përcakton se “Kjo procedurë zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës” pra nuk janë respektuar përcaktimet ligjore të nenit 144 pikat:

1) *Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedoj me të.*

2) *Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë dhe i jep atij mundësi për t’u shprehur.*

3) Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit.

Si dhe në pikën 5 përcaktohet se “Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen, detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy muajsh pagë, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme” e cila nuk është cituar në urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Ankesë dërguar me shkresën nr. 669, datë 14.05.2024, nga R. M., ku pretendon se:

Ankesa:

Me shkresën Nr.984, date 07.02.2024, "Njoftim për diskutim të marrëdhënieve të punës", me është njoftuar të paraqitem në ambientet e AKBN-së, për të diskutuar marrëdhënien time të punës. Për shkak të arsyeve shëndetësore dokumentuar Raportet Shëndetësore të lëshuara nga mjekja e familjes datë 12.02.2024-17 .02.2024 dhe datë 19.02.2024-24.02.2024. Në datën 26.02.2024 jam paraqitur pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore për t’i vendosur në dijeni pasi e-mail zyrtar që më është vendosur në dispozicion nga ana e institucionit ishte jashtë funksionit. Me shkresën Nr. 984/1, datë 29.02.2024, "Njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës", me është bërë me dije se kontrata ime e punës është zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga institucioni për shkak të pamundësisë financiare, si dhe nuk më është vënë në dispozicion mënyra e përzgjedhjes së emrit tim nga ana e Komisionit, pra kriteret që ka mbajtur parasysh Komisioni apo Drejtori Ekzekutiv; apo për t’u njohur me ndonjë urdhër Ministri apo urdhër të brendshëm të titullarit të institucionit për shpalljen e pamundësisë financiare, gjithmonë n.q.s. ka patur një të tillë, si dhe për të marr dijeni përse nuk është respektuar Kodi i Punës (kriteret si vjetërsia, apo performanca në punë). Nuk kam marrë asnjë përgjigje. Marr shkas të mendoj se jam në kushtet e diskriminimit dhe jo të pamundësisë financiare pasi titullari i AKBN -së në datë 23.01.2024, ka emëruar specialit st-jurist në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit i ka citur të gjitha këto problematika për të cilën janë lënë rekomandime për tu zbaruar nga AKBN-ja ne raportin përfundimtar të auditimit.

Ankesë: Gjithashtu më është penguar dhënia e referencës në punë, duke më penguar të kërkojë një punë të re sikurse përcaktohet edhe në nenin 143, të Kodit të Punës. Gjykojë se jam penguar qëllimisht nga ana e institucionit, pasi dokumentuar edhe me shkresën Nr.1506, datë 01.03.2024, nuk ka pasur asnjë masë administrative ndaj meje as për kohën e punës (paraqitja dhe largimi në oraret e caktuara sipas VKM nr. 568, datë 06.10.2021, dhe as për mënyrën e realizimit të detyrave të mija funksionale apo grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me referencën që ju kërkonti është kompetencë e titullarit. Titillari i AKBN-së të marrë masa menjëherë për lëshimin e referencës në punë, ndaj punonjësve, që është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punës, në mënyre të njëanshme nga AKBN.

Ankesë dërguar me shkresën, nga E. D. ku pretendon se:

Ankesa:

Me shkresën nr. 982, datë 07.02.2024, "Njoftim për diskutim të marrëdhënieve të punës", me është njoftuar të paraqitem në ambientet e AKBN-së, për të diskutuar marrëdhënien time të punës.

Ne komisionin e ngritur nuk mu dha asnjë përgjigje për pyetjet e ngritura. Megjithëse kryetari i grupit te ngritur ishte drejtori Juridik ne komision nuk ishte prezent.

Për t’u njohur me mënyrën e përzgjedhjes së emrit tim nga ana e Komisionit, pra kriteret që ka mbajtur parasysh Komisioni apo Drejtori Ekzekutiv (pasi as nga ana e Komisionit dhe as nga ana e titullarit nuk ka patur në asnjë moment transparence.

Për t’u njohur me ndonjë urdhër Ministri apo urdhër të brendshëm të titullarit të institucionit për shpalljen e pamundësisë financiare, gjithmonë n.q.s. ka patur një të tillë. Unë jam grua e ve dhe nene e dy fëmijëve njeri prej te cilëve është i mitur dhe bej pjese ne grupet e veçanta sipas një vendimi nr.27, date 11.01.2012 për programin e nxitjes se punësimit te grave dhe vajzave nga grupet e veçanta.

Marr shkas të mendoj se jam në kushtet e diskriminimit dhe jo të pamundësisë financiare pasi AKBN-ja ka vazhduar dhe vazhdon të kryhet haptazi çdo ditë duke shpallur vende vakante dhe duke bërë punësime të reja çdo ditë, konfirmuar kjo edhe nga publikimet në faqen zyrtare:

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit i ka citur të gjitha këto problematika për të cilën janë lënë rekomandime për tu zbaruar nga AKBN-ja ne raportin përfundimtar të auditimit.

Në RPA është kërkuar që të analizohen këto parregullsi dhe të procedohet me marrjen e masave të nevojshme disiplinore e administrative, për parregullsitë e konstatuara.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se:

-Nga Drejtoria e Administratës nuk janë marrë masat për hartimin dhe paraqitjen për miratim të planit vjetor të nevojave për personel drejtuar Drejtorit Ekzekutiv bashkë me propozimet e ardhura nga Drejtoritë e AKBN-së.

Për Procedurat e emërimit të punonjësve për vitin 2022 në total 13 raste dhe për vitin 2023 në total 4 raste, Drejtoria e Administratës ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë për plotësimin e kriterëve të kërkuara me dosjen e dorëzuar të aplikantit, dhe në të njëjtën kohë ka qenë monitoruese dhe pjesë e komitetit Ad Hoc të përzgjedhjes së kandidatëve.

- Kriteret e vendosura në njoftimin për WEB janë ndryshuar nga kriteret e kërkuara nga Drejtori i drejtorisë përkatëse, që bën kërkesën për plotësimin e pozicionit me specialistin e fushës, veprim i cili nuk është shoqëruar me një procesverbal të mbajtur midis palëve për ndryshimin e kriterëve veprim në kundërshtim me Statut-rregulloren dhe Rregulloren e AKBN-së.

- Në kriteret e kërkuara përcaktohet se aplikanti duhet të ketë kryer studimet specifike të universitetit/fakultetit (si p.sh. Fakulteti i Ekonomisë ose Universiteti Politeknik i Tiranës) dhe jo përcaktimi i fushës së studimit. Kriteret e kërkuara nuk janë objektive dhe janë diskriminuese, duke ndikuar në trajtimin e pabarabartë për të gjithë aplikantët në tregun e punës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Statut-rregulloren miratuar prej Ministrisë me vendimin nr. 545, datë 05.07.2018, si dhe Rregullores së AKBN-së miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr.7, datë 20.06.2018, nenin 25, pikës 2 dhe 26. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 9-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, të marrë masa në vijimësi, që në urdhrin për ngritjen e komisionit Ad Hoc, për rekrutimin e punonjësve, anëtarët e tij të mos jene në kushtet e konfliktit të interesit me pozicionin dhe përshkrimet e punës të përcaktuara në Statut-rregulloren dhe Rregulloren e AKBN-së.

Në Vijimësi

1.2.Rekomandimi: Nga AKBN, të merren masa në vijimësi, që rekrutimi i punonjësve të kalojë fazat e përcaktuara në Rregulloren e brendshme, dhe jo vetëm nga vlerësimi i dosjes së dorëzuar nga aplikanti.

Në Vijimësi

1.3.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Administratës së AKBN-së, të merren masat në vijimësi që kriteret e përgjithshme të kërkuara për pranimin e punonjësve në punë të shpallura në faqen zyrtare WEB të bazohen në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike dhe të mos bien ndesh me kriteret e kërkuara nga Drejtoret e Drejtorive përkatëse.

Në Vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se:

- Nga institucioni nuk është plotësuar regjistri i personelit, duke mos evidentuar lëvizjet e kryera brenda institucionit, lëvizjet nga një pozicion i punës në tjetrin si dhe largimet nga puna dhe rekrutimet e punonjësve të rinj etj, veprime në kundërshtim me VKM-në me nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” paragrafi III dhe VII.

- Në të gjithë dosjet e shqyrtuara mungonte fleta e inventarit, e cila duhet të firmoset nga vetë punonjësi dhe nga punonjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, i ngarkuar me administrimin e dosjeve personale të punonjësve.

- Nga auditimi i listë prezencave nga sektorët dhe drejtoritë e AKBN-së për vitin 2022 dhe vitin 2023 rezultoi se ato nuk janë firmosur dhe miratuar nga Drejtori i Administratës, së AKBN-së. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të AKBN-së neni 26 pika 3 dhe pika 5. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 9-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Administratës së AKBN-së, të marren masat të menjëhershme për plotësimin e regjistrit të personelit, dosjeve personelit, si dhe të ndiqen procedurat e parashikuara, me qëllim menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:

3.1. Nga auditimi i dosjeve të personelit rezultoi se për tre punonjës është lidhur kontratë me palëve pa ndjekur procedurën e rekrutimit, si dhe në mosplotësim të kriterëve për pozicionin e përkatës, parashikuar në rregulloren e brendshme të AKBN-së, në seksionin “Përshkrim i punës”.

3.2. Nga auditimi mbi emërimet rezultoi se, kalimet nga një kategori në tjetrën të punonjësve (ku një pjesë e lëvizjeve janë nga specialist në shef sektori, pa kaluar më parë Specialist i parë) janë të pa bazuara në një vlerësim performace të stafit, pasi në AKBN për vitet me radhë nuk është bërë asnjë vlerësim performace. Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, dhe me Nenin 10 “Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë” të Rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

3.3. Nga auditimi rezultoi se për tre punonjës me urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së është bërë emërimi i përkohshëm, deri në plotësimin e vendit vakant ose deri në rikthimin në punë të punonjësit në këtë pozicion, ku në pikën 2 të urdhrit është përcaktuar edhe ndryshimi i të drejtave financiare/paga, pa përcaktuar bazën ligjore dhe nënligjore ku mbështet urdhrin për ndryshimin e të drejtave financiare. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 9-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Nga AKBN, të merren masat të menjëhershme për rishikimin e rregullores së brendshme, duke parashikuar rregulla të qarta në lidhje me rekrutimin e punonjësve, emërimet e përkohshme, si dhe procedurave të ngritjes në detyrë të stafit, me qëllim mirë administrimin e proceseve të punës në realizimin e objektivave të institucionit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i dosjeve të largimit të stafit rezultoi se në 11 raste, largimet nga puna kanë ardhur si shkak i përfundimit/zgjidhjes së kontratës për arsye të cilat lidhen me vështirësinë financiare të institucionit.

- Në 4 raste largimet janë shkëputja e marrëdhënieve për punonjës me kontratë më afat të cilat janë lidhur me datën 29.12.2023, ndërkohë që AKBN ka qenë në vështirësi financiare, pasi kishte që nga muaji nëntor 2023 që nuk paguante pagat e stafit.

- Në njoftimin për zgjidhjen e kontratës është cituar se mbështetur në nenin 141 e vijues të Kodit të Punës të RSH. Këta punonjës kanë qenë me kontratë me afat dhe nuk janë në kushtet e nenit 141 “Zgjidhja”, ku përcaktohet “Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit”.

- Për 5 raste, punonjësit e tjerë të larguar, 4 prej tyre e kanë kundërshtuar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe një nga punonjësit nuk është paraqitur edhe pas njoftimit nga komisioni për marrjen pjesë në takim dhe mbledhjes tre here të komisionit për ti komunikuar arsyen e shkëputjes së marrëdhënieve të punës.

Sa më sipër, për 4 punonjës, në procesverbalet e mbajtura dhe në takime kanë marrë pjesë dhe kanë firmosur vetëm katër anëtarë. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore i cili është pjesë e komisionit nuk ka marrë pjesë në takime dhe nuk ka firmosur asnjë procesverbal, duke mos dhënë dokortësinë apo mosdakortësinë në lidhje me procedurën.

- Nga auditimi i dosjes për 3 punonjësit e larguar rezultoi se:

Në asnjë rast nuk janë përcaktuar shkaqet e justifikuar të largimit nga puna sipas përcaktimit të nenit 153 të Kodit të Punës. Sipas së cilit, dy janë kushtet kryesore për t'u plotësuar që zgjidhja e kontratës të jetë e rregullt dhe e justifikuar: *kushtet subjektive dhe kushtet objektive*. Sa më sipër, zgjidhjet e njëanshme të kontratave të punës dhe largimet e paargumentuara të punonjësve nga puna, sipas Kodit të Punës, mund të çojnë në *shkaktimin e dëmit ekonomik*, si pasojë e proceseve gjyqësore, të cilat mund të iniciohen nga punonjësit e larguar pa shkaqe të justifikuar.

- Në një rast është bërë shkëputja e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, duke mospranuar kërkesa për dorëheqje e paraqitur me e-mail nga punonjësit, ku nga punonjësi është kërkuar ndërprerja e marrëdhënies të punës sipas dispozitave ligjore në fuqi. Kërkesa nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është bërë pjesë e dosjes.

Nga AKBN nuk është respektuar neni 144, pika 4 e Kodit të Punës, ku përcaktohet se, “Kjo procedurë zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës”, si dhe në pikën 5 përcaktohet se “Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen, detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy muajsh pagë, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme” e cila nuk është cituar në urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 9-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore të AKBN-së të merren masat e nevojshme për mirëadminisrimin e burimeve njerëzore, në respektim të Kodit të Punës dhe Statut-rregullores dhe Rregullores së AKBN-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua se:

- Drejtori i Administratës është kryetar i komisionit të blerjeve me vlerë të vogël dhe në të njëjtën kohë miraton kërkesat për nevojat, zhvillon procedurat e prokurimit, merr në dorëzim mallrat/shërbimit në rolin e komisionit të marrjes në dorëzim të tyre, si dhe referuar urdhrin me nr. 31, (prot. 2149) datë 07.02.2018, Drejtori i Administratës është pjesë e “Njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizueseve.”

Sa më sipër kemi mospërputhshmëri të funksionit të Drejtorit të Administratës, ku mungon një ndarje e qarte e roleve, funksioneve dhe përgjegjësive administrative, pasi i njëjti punonjës nuk mund të jetë njëkohësisht Drejtor Administrate, kryetar komisioni blerjesh dhe në të njëjtën kohe dhe sinjalizuese.

- Nga titullari i Institucionit, në asnjë vit nuk është ngritur urdhër për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku në pikë 42. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 9-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Nga Titullari i AKBN të merren masa, që të identifikohen në mënyre të qartë rolet, funksionet dhe përgjegjësive administrative të zyrtarëve dhe në ngritjen e komisioneve për çështje të caktuara të funksionimit të brendshëm të AKBN-së të mbahen

parasysh përcaktimet ligjore në fuqi, me qëllim shmangien e kushteve të konfliktit të interesit, si dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua se, ka mospërputhje midis datës së kryerjes së këtyre procedurave dhe pranisë fizike në institucion të zyrtareve, pjesë e realizimit të këtyre procedurave. Me konkretisht:

- Në tre procedura, kryetari e komisionit ka qenë me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta.

Gjithashtu, nga auditimi i listë prezencës për muajin Shkurt, Mars, Maj, Qershor, Tetor dhe Nëntor 2022 rezultoi se: Drejtori i Administratës është trajtuar financiarisht në shumën prej 121,000 lekë për shërbim jashtë qendrës së punës, e cila nuk figuron në listëprezencë me shërbim, ashtu siç deklarohet për të gjithë punonjësit, ku në datat të cilat kanë qenë me shërbim dhe janë paguar për shpenzime dieta janë shënuar në listëprezencën me shërbim, bazuar në Rregulloren e Brendshme të AKBN-së. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 9-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Nga AKBN të merren masa për vlerësimin e dokumentacionit, në lidhje me shumën prej 121,000 lekë përfituar padrejtësisht nga Drejtori i Administratës, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e vlerës.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se AKBN duke qenë në kushte të vështira financiare ka bërë deklaratimet e “Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” si dhe “Deklarimi mujor i tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (TAP)”, por nuk janë derdhur ato për muajt Nëntor –Dhjetor 2023 dhe Janar Shkurt 2024, ku vlera e përlllogaritur e sigurimeve dhe TAP të papaguar është në shumën prej 36,659,853 lekë.

Veprime në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 i ndryshuar “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” neni 10 dhe nenit 8; si dhe Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 19, 76 dhe 114.

Mos derdhja e detyrimeve ka sjellë vlerë financiare për tu paguar për kamatëvonesat dhe gjobë për pagesë të vonuar, e cila vazhdon të akumulohet dhe të rritet për faktin se vlera e kamatëvonesës llogaritet mbi vlerat të cilat janë të papaguara. Deri me datën 29.03.2024 vlera e përlllogaritur e kamatëvonesave dhe gjobave për pagesë të vonuar është në shumën prej **1,632,573 lekë**, që konsiderohet nga KLSH si efekt financiar negativ për fondet publike që administrohen nga AKBN. *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në faqe 9-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: AKBN në bashkëpunim me Ministrinë e linjë/Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masa të menjëhershme për raportimin e situatës dhe gjetjen e mundësive të zgjidhjes, me qëllim shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve dhe TAP.

D.1. MASA ADMINISTRATIVE DHE DISIPLINORE

Bazuar ne përcaktimet e Nenit 10 dhe 11, te Statut-Rregullores se AKBN, miratuar nga Ministri me vendimin me nr. 545, datë 05.07.2018, Këshilli Drejtues i AKBN dhe Drejtori Ekzekutiv të analizojnë parregullsitë e shkeljet e konstatuara dhe te marrin masat e nevojshme disiplinore e administrative, sipas çështjeve dhe përgjegjësive të trajtuara në raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nga Titullari i Institucionit të AKBN-së të merren masat që të analizohen këto parregullsi dhe të procedohet me marrjen e masave të nevojshme disiplinore e administrative, si dhe në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në mënyre të njëanshme nga AKBN, të ndiqen të gjitha procedurat për përcaktimin e shkaqeve për ndërprerjet e marrëdhënieve të punës në rastet e kontratave me afat të caktuar apo pa afat, me qëllim shmangien e shkaktimit të dëmit nga mos ndjekja në përputhje me kriteret e përcaktuara për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Për punonjësit si mëposhtë vijon:

1. **Z. B. P.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore
2. **Znj. M. H.**, me detyrë Specialiste e Parë pranë Sektorit të burimeve njerëzore
3. **Znj. H. Z.**, me detyrë Specialiste e Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore
4. **Z. E. Ll.**, me detyrë Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore

Në rolin e komisionit të ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06.02.2024 “Për ngritjen e komisionit për përgatitjen dhe ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore me punonjësit për të cilin është parashikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës”.

D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; geramat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale të punës, nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte: “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga puna” përkatësisht për znj. S. H me detyrë ish- Drejtor Administrate deri me datën 02.02.2024, mbështetur në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH si vijon:

-Nga Drejtoria e Administratës nuk janë marrë masat për hartimin dhe paraqitjen për miratim të planit vjetor të nevojave për personel drejtuar Drejtorit Ekzekutiv bashkë me propozimet e ardhura nga Drejtoritë e AKBN-së.

- Për Procedurat e emërimit të punonjësve për vitin 2022 në total 13 raste dhe për vitin 2023 në total 4 raste, Drejtoria e Administratës ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë për plotësimin e kriterëve të kërkuara me dosjen e dorëzuar të aplikantit, dhe në të njëjtën kohë ka qenë monitoruese dhe pjesë e komitetit Ad Hoc të përzgjedhjes së kandidatëve.

- Kriteret e vendosura në njoftimin për WEB janë ndryshuar nga kriteret e kërkuara nga Drejtoria i drejtorisë përkatëse, që bën kërkesën për plotësimin e pozicionit me specialistin e fushës, veprim i cili nuk është shoqëruar me një procesverbal të mbajtur midis palëve për ndryshimin e kriterëve veprim në kundërshtim me Statut-rregulloren dhe Rregulloren e AKBN-së.

- Në kriteret e kërkuara përcaktohet se aplikanti duhet të ketë kryer studimet specifike në universitetin/fakultetin (si p.sh. Fakulteti i Ekonomisë ose Universiteti Politeknik i Tiranës) dhe jo përcaktimi i fushës së studimit. Kriteret e kërkuara nuk janë objektive dhe janë diskriminuese, duke ndikuar në trajtimin e pabarabartë për të gjithë aplikantët në tregun e punës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Statut-rregulloren miratuar prej Ministrisë me vendimin me nr. 545, datë 05.07.2018, si dhe Rregullores së AKBN-së miratuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr.7, datë 20.06.2018, nenin 25, pikës 2 dhe 26.

- Nga auditimi i listë prezencave nga sektorët dhe drejtoritë e AKBN-së për vitin 2022 dhe vitin 2023 rezultoi se ato nuk janë firmosur dhe miratuar nga Drejtori i Administratës, së AKBN-së.

- Nga auditimi i dosjeve të personelit rezultoi se për tre punonjës është lidhur kontratë mes palëve pa ndjekur procedurën e rekrutimit, si dhe në mosplotësim të kriterëve për pozicionin e përkatës, parashikuar në rregulloren e brendshme të AKBN-së, në seksionin “Përshkrim i punës”.

- Nga auditimi mbi emërimet rezultoi se, kalimet nga një kategori në tjetrën të punonjësve (ku një pjesë e lëvizjeve janë nga specialist në shef sektori, pa kaluar më parë Specialist i parë) janë të pa bazuara në një vlerësim performance të stafit, pasi në AKBN për vitet me radhë nuk është bërë asnjë vlerësim performance. Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe manualin e MFK-së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, dhe me Nenin 10 “Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë” të Rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua se:

- Drejtori i Administratës është kryetar i komisionit të blerjeve me vlerë të vogël dhe në të njëjtën kohë miraton kërkesat për nevojat, zhvillon procedurat e prokurimit, merr në dorëzim mallrat/shërbimit në rolin e komisionit të marrjes në dorëzim të tyre, si dhe referuar urdhrin me nr. 31, (prot. 2149) datë 07.02.2018, Drejtori i Administratës është pjesë e “Njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizueseve.”

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua se, ka mospërputhje midis datës së kryerjes së këtyre procedurave dhe pranisë fizike në institucion të znj.S. H. në rolin e kryetares së Komisionit blerje me vlerë të vogël, e cila në tre procedurat e realizuara ka qenë me shërbim jashtë qendrës së punës së AKBN-së, vërtetuar me dokumentacionin e pagesave nga banka për shpenzime shërbime-dieta.

- Gjithashtu, nga auditimi i listë prezencës për muajin Shkurt, Mars, Maj, Qershor, Tetor dhe Nëntor 2022 rezultoi se: Drejtori i Administratës është trajtuar financiarisht në shumën prej 121,000 lekë për shërbim jashtë qendrës së punës, e cila nuk figuron në listëprezencë me shërbim, ashtu siç deklarohet për të gjithë punonjësit, ku në datat të cilat kanë qenë me shërbim dhe janë paguar për shpenzime dieta janë shënuar në listëprezencën me shërbim, bazuar në Rregulloren e Brendshme të AKBN-së dhe metodologjisë së përdorur nga institucioni për listëprezencat.

Për sa më sipër, paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT